



Hamdi Mramori Street, No 1
Prishtina 10000 – Kosovo
Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103
Fax: +381 (0) 38 247 620
e-mail: info@ero-ks.org
www.ero-ks.org

RAPORT

**Mbi monitorimin e implementimit nga KEK-u të Rregullave dhe
Vendimeve të aprovuar nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë**

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTË

Objektivi i vizitës katër ditore në Divizionet e Furnizimit dhe Shpërndarjes ishte që të vlerësohet:

- a) zbatimi i Rregullave dytësore të aprovuara nga ZRRE-ja;
- b) zbatimi i vendimeve të nxjerra nga ZRRE;
- c) efektet pozitive në rritjen e faturimit dhe arkëtimit, përkatësisht zvogëlimin të humbjeve komerciale, dhe
- d) përmirësimi i marrëdhënieve me konsumatorët.

Statistikat e mbledhura nga KEK-u duhet të ishin treguesit e çfarëdo lëvizjeje pozitive në zbatimin e rregullave në fuqi dhe vendimeve të veçanta.

Objektiv tjetër i rëndësishëm është të vlerësohet njohuria e Rregullave Dytësore dhe Vendimeve të miratuara nga ZRRE-ja dhe ballafaqimi me problemet eventuale gjatë zbatimit si dhe dhënia e sqarimeve sipas nevojës.

ZRRE-ja ka vlerësuar zbatimin e Legjislacionit Dytësor dhe dispozitave të vendimeve nga KEK-u, ka analizuar rezultatet, dhe në fund ka dhënë udhëzimet për veprimet e ardhshme në aplikimin e kornizës rregullative, si nevojë për rritjen e përmbushjes së detyrave.

Raporti i monitorimit nuk pretendon të vlerësojë zbatimin e kornizës rregullative lidhur me humbjet e energjisë elektrike meqenëse Rregulli mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji është aprovuar në fund të qershorit 2006 dhe gjatë monitorimit nuk është marrë parasysh.

Sidoqoftë, rregulloret e vlerësuara dhe statistikat e marra po na shprien drejt gjetjeve të rëndësishme që mund të konsiderohen si të zakonshme në këtë nivel monitorimi. Një shqyrtim më i thellë i politikave të tjera mund të sjellë gjetje tjera të rëndësishme që mund të zgjerojnë përfundimet e raportit; ne shpresojmë se kjo do të ndodhë në ciklin e ardhshëm monitorues.

II. GJETJET E RËNDËSISHME

- II.1 Ekziston nevoja për zbatim të menjëhershëm të të gjithë legjislacionit dytësor në mënyrë që të arrihen rezultate të kënaqshme në rritjen e normës së arkëtimit (inkasimit), duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve në furnizimin me energji.
- II.2 Zbatim i legjislacionit të veçantë kërkon përgatitjen e politikave të ndërmarrjeve dhe një procedurë të brendshme të përshtatshme që duhet të vijohet nga plani i veprimit.
- II.3 Zbatimi i pjesshëm i çdo rregulloreje ose vendimi mund të rrezikojë secilën prej tyre, qoftë nëse ndërmerret prej enteve që janë të mandatuar për këtë, ose ndonjë vendim të brendshëm të marrë prej ndërmarrjes.
- II.4 Zbatimi në shkallë të gjerë i politikës së shkyçjes në periudhën e shikuar pa zbatimin e duhur të kriteve të politikës së mosmarrëveshjeve, politikës ABC dhe për të zbuluar

vjedhjen e energjisë elektrike dhe korrupsionin e njehsorit, nuk kanë sjellë përmirësime të kënaqshme në normën e arkëtimit, edhe pse numri i konsumatorëve të shkyçur ka qenë i madh.

- II. 5 Veprimet e ndërmarra në mënyrë që të rritet norma e arkëtimit nuk e ka rritur besimin e konsumatorit ndaj KEK-ut, gjë që është treguar nga numri i rritur i konsumatorëve pagues që janë prekur nga shkyçjet.

III. PËRFUNDIME:

- III. 1 Duke iu referuar përfundimeve prej raportit monitorues qëllimi kryesor i të cilit ka qenë të vlerësojë si dhe në çfarë mase është zbatuar legjislacioni rregullativ (korniza rregullative e cila rreket të krijojë kushtet për arritjen e rezultateve më të mira dhe do të pasqyronte rritjen e arkëtimit të të ardhurave vjetore në krahasim me të tashmen), ne mund të deklarojmë se ka disa iniciativa elementare dhe se ato tregojnë rezultate fillestare.
- III. 2 Tani që legjislacioni rregullativ është përfunduar dhe bazuar në faktin se ky legjislacion mbyll të gjithë proceset e relacionit midis shërbimit të ofruar dhe konsumatorit, duhet të ndërmerret një veprim i domosdoshëm gjithëpërfshirës për zbatimin e tij.
- III. 3 Intervistat me ekzekutivët direkt tregojnë se kjo rregullore është një element i ndihmës së mirë për të përmirësuar marrëdhënien me konsumatorët dhe që mund të zvogëloj humbjet komerciale dhe rritë arkëtimin e të ardhurave vjetore. Zbatimi i dispozitave të rregullave të përmendura, do të pakësonte sjelljet arbitrare në lidhje me konsumatorët.

IV. HYRJJE

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”) për të përmbushur detyrimet që rrjedhin prej Nenit 54 c) të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, ka vizituar disa departamente lokale të KEK-ut në mënyrë që të monitorojë situatën. Vizita janë bërë në:

- Rrethin e Pejës më datë 29.06.06
- Rrethin e Ferizajt më datë 30.06.06
- Rrethin e Prishtinës më datë 03.07.06

dhe mbledhje punuese me Menaxhmentin e Divizioneve të Furnizimit dhe Rrjetit në Prishtinë më datën 04.07.06

Agjenda e këtyre takimeve punuese/monitoruese ka qenë si në vijim:

- **Monitorimi i zbatimit të Rregullave të nxjerra nga Bordi i ZRRE-së;**
- **Monitorimi i zbatimit të politikës ABC;**
- **Monitorimi i zbatimit të Shkëqjeve Individuale të Konsumatorëve;**
- **Analiza e problemeve me të cilat ballafaqohen këto Distrikte si dhe kërkesat e tyre për mbështetje rregullatore.**

V. PËRFUNDIME TË VEÇANTA TË RREGULLAVE TË MONITORUAR

Monitorimi i implementimit të Rregullave të lëshuara nga ZRRE-ja

1. Rregulli mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë është miratuar nga Bordi i ZRRE-së më 17.01.2006

1.1. Ky Rregull përcakton procedurën bazë që aplikohet për ankesat e konsumatorëve dhe detyrimet e ndërmarrjeve të energjisë në lidhje me ankesat e konsumatorëve. Qëllimi i vizitës punuese/monitoruese ka qenë të shihet se sa është i njoftuar stafi përgjegjës nëpër Rrethe me Rregullin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe sa është duke u zbatuar në praktikë ky Rregull.

1.2. Rezultatet e Monitorimit

1.2.1. Nga koordinatorët për kujdesie ndaj konsumatorëve nëpër Rrethet e Divizionit të Furnizimit është thënë se nga niveli qendror janë të njoftuar me Rregullin dhe se Rregulli në fjalë u është shpërndarë koordinatorëve përgjegjës për implementimin e tij.

1.2.2. Për të parë se sa po zbatohen procedurat që rrjedhin nga ky Rregull, stafi i ZRRE-së ka kërkuar nga koordinatorët e përkujdesjes ndaj konsumatorëve disa nga ankesat e konsumatorëve. Ankesat janë të llojeve të ndryshme siç mund të shihen në Tabelën 1.

1.2.3. Në përgjigjet që koordinatorët e përkujdesjes ndaj konsumatorëve u japin konsumatorëve në ankesat e tyre është vërejtur se procedurat që parashihen në këtë Rregull nuk përfillen sa duhet:

- a) konsumatorët nuk udhëzohen në lidhje me të drejtat e tyre për të paraqitur ankesë tek ZRRE-ja;
- b) konsumatorët nuk informohen për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve përmes negocimit dhe ndërmjetësimit;
- c) komunikimet telefonike me konsumatorin në lidhje me ankesat e vogla nuk regjistrohen; dhe
- d) departamentet për kujdesin ndaj konsumatorëve nuk posedojnë ndonjë libër regjistri për këto ankesa.

1.2.4. Nëse i referohemi Tabelës 1 në rreshtin e fundit paraqiten një numër i konsiderueshëm i kërkesave dhe ankesave të emëtuara si “të tjera” që pasqyrojnë se konsumatorët gjatë marrjes së shërbimit paraqesin edhe probleme të natyrës që janë të lidhura me rrjetin. Zyrtarët e KEK-ut nuk na janë paraqitur me një procedurë të qartë për mënyrën se si janë trajtuar këto raste dhe i janë lënë një pune “ad-hoc” në baza të bashkëpunimit në mes të furnizimit dhe rrjetit. **Kjo tregon se nuk është zhvilluar aplikimi i politikës së brendshme të Rregullit mbi Zgjidhjen e Kontesteve.**

1.2.5. Mungesa e formulimit të politikave të qarta në raport me konsumatorët mund të shpjegohet edhe me rastin e kontestit të ngritur nga konsumatori “BIRILIK” në

komunën e Mamushës, njehsori i të cilit nuk ka qenë në rregull dhe procedurat e ndjekura hapin mundësinë e ngritjes së kontesteve nga konsumatorët edhe pse të gjitha faktet drejtojnë në një rast shumë të qartë të shpërdorimit të energjisë elektrike. Më poshtë mund të shihet kronologjia e veprimeve:

- Procesi nr. 20/3 i datës 20.05 2004 i kontrollit të instalimit dhe njehsori në gjendjen si është blombuar (por ky Proces nuk qartëson se çka është blombuar, njehsori apo kapaku ku kyçen përçuesit e fazave të rrymave dhe tensionet) ;
- Procesi nr. 0001805 i dt. 24.05.2004 mbi konstatimin e shpenzimit të jashtëligjshëm me ndërrimin e fazave dhe natyrisht konstatimi se mungon blomba e kapakut. Procesverbali konstaton vendosjen e bombave(vulave) tjera dhe vetëm mund të supozohet se njehsori është sjell në gjendje të rregullt për të matur tërë energjinë e shpenzuar;
- Procesi nr. 0001806 i dt. 07.06.2004 që konstaton sërish gjendjen jo të rregullt të lidhjeve të njehsorëve dhe transformatorëve të rrymës;
- Procesverbali nr. 17 i dt. 11.06.2004 që konstaton rregullimin e lidhjeve për matje korrekte të energjisë së shpenzuar;
- Njoftimi i pa datë qartë njofton konsumatorin për shfrytëzim të pa autorizuar të energjisë elektrike duke i ndikuar vlerën e dëmit (data e supozuar 05.10.2004);
- Fatura nr 294/1 e dt. 2004;
- Urdhërngarkimi i kontos së konsumatorit nr. 2642 i dt. 05.10.2004;
- Përgjigja e KEK-ut e dt. 16.05.2006 në ankesën e ngritur nga konsumatori me datë 31.01.2006;

1.2.6. Në rastin e përshkruar në Nenin 1.2.5 shihet se mungojnë: a) komunikimi ndërmjet KEK-ut dhe konsumatorit, b) ankesa e konsumatorit dhe c) nuk ka njoftim se nëse lënda është proceduar në Gjykatë kompetente.

Por edhe nëse do të ishte proceduar i tërë dokumentacioni, procedurat e ndjekura nuk japin fakte të qarta që një rast i tillë të trajtohet nga Gjykata kompetente në mënyrë të duhur. Konsumatori mund të konsiderohet si borxhli dhe tani paraqitet si rast pranë ZRRE-së. Prandaj në vend që të vërtetohet vjedhja e energjisë elektrike dhe ngacmimi i njehsorit dhe të procedohet në Gjykatë, procedura e ndjekur mundëson vetëm të kërkohet nga konsumatori që të paguajë borxhin për energjinë elektrike të konsumuar për një periudhë kohore të limituar.

1.2.7. Nga Tabela Nr.1 mund të shihet se ka shumë ankesa që konsumatorët kanë për energjinë e shpenzuar “mbi-limit”*, lexim jo të rregullt të njehsorëve dhe ndryshimin e kategorisë së energjisë së shfrytëzuar pa njehsor (paushall).

1.2.8. Obligimet që dalin nga Rregulli për Zgjidhje të Kontesteve në Sektorin e Energjisë janë:

- a) Furnizuesi është përgjegjës për të publikuar politikën e vet në lidhje me ankesat në faqen zyrtare elektronike dhe përmes botimeve në shtyp, lajmërimeve, raporteve ose ndonjë mënyrë tjetër që mendohet si më e përshtatshme.

Statusi: Nuk është zbatuar.

* Mbi-limit është konsumi i energjisë që shfrytëzohet mbi 800 kWh për të cilën aplikohet çmim më i lartë

b) Furnizuesi do t'i paraqesë llojet e formave të ankesave në ZRRE për aprovim.

Statusi: Nuk është zbatuar

c) Brenda afatit nëntëdhjetë (90) ditor prej datës së publikimit të këtij rregulli në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, furnizuesi do të nxjerrë politikat për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me këtë Rregull, dhe t'ia paraqesë ZRRE-së për aprovim. Kjo politikë duhet të përfshijë planin për zgjidhjen e kontesteve ekzistuese në kohën e nxjerrjes së këtij Rregulli

Statusi: Nuk është zbatuar

d) Çdo 6 muaj furnizuesi duhet të dorëzojë një raport në ZRRE mbi procedurën e vet për zgjidhjen e ankesave.

Statusi: Nuk është zbatuar

Menaxheres për kujdesin ndaj konsumatorëve iu kërkuan arsyet për mospërbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Rregulli për Zgjidhjen e Kontesteve në Sektorin e Energjisë, dhe ajo tha se janë duke u përpunuar politikat në lidhje me këtë Rregull dhe se së shpejti do të dërgohen në ZRRE për aprovim si dhe do të ndërmerren hapat për zbatimin në praktikë të këtij Rregulli.

Tabela 1 Numri i ankesave për periudhën Janar – Maj 2006

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Total
Pagesë e paregjistruar	12	12	23	14	18	79
Bilanci fillestar gabim	70	49	64	52	67	302
Mosmarrje e faturave	5	2	5	3	0	15
Mbi-limiti	693	854	869	972	755	4143
Ndryshimi i paushallit	87	177	193	184	153	749
Lexim i pasaktë	43	72	62	68	91	336
Lexim jo i rregullt	25	691	247	445	254	1662
Njehsorë jo i saktë	25	42	27	55	11	160
Kërkesë për shlyerje të borxhit	51	59	110	61	55	336
Ngarkuar me TVSH	13	2	3	2	3	23
PEP	14	22	21	13	17	87
Të tjera	909	1130	1305	1050	928	5322

Gjithsej	1947	2608	2929	2919	2352	12755
----------	------	------	------	------	------	-------

Tabela 2 Numri i ankesave të Zgjidhura pozitivisht për periudhën Janar- Maj 2006

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Total
Pagesë e paregjistruar	10	10	19	13	15	69
Bilanci fillestar gabim	56	49	58	46	58	267
Mosmarrje e faturave	5	0	4	7	0	16
Mbi-limiti	553	829	808	891	700	3781
Ndryshimi i paushallit	80	164	180	165	147	736
Lexim i pasaktë	51	57	54	81	83	326
Lexim jo i rregullt	22	169	226	390	232	1039
Njehsorë jo i saktë	15	31	23	45	11	125
Kërkesë për shlyerje të borxhit	45	56	101	50	49	301
Ngarkuar me TVSH	13	2	3	3	3	24
PEP	14	22	21	13	17	87
Të tjera	781	1052	1107	892	812	4644
Gjithsej	1645	2443	2604	2596	2127	11415

Nga tabelat 1 dhe 2 shihet se prej 12,755 ankesave te konsumatorëve janë zgjidhur pozitivisht ne favor të konsumatorëve 11,415 apo 89.4% të ankesave

Tabela 3 Llojet e thirrjeve të konsumatorëve Janar - Maj

Muaji	Llojet e Thirrjeve / Type of Calls				nr. i thirrjeve/n o.of calls
	Informative Informative	Ankesë Compliant	Dështim i rrjetit Network failure	Denoncim Denouncement	
Janar	909	373	100	2	1388
Shkurt	1081	325	214	9	1629
Mars	1838	220	194	3	2255
Prill	1588	153	90	3	1834
Maj	693	58	84	4	839
Total 2006	6109	1129	682	21	7945

2. Rregulli mbi Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë miratuar nga Bordi i ZRRE-se më datë 24.02.2006

- 2.1. Ky Rregull përcakton kriteret, termat, kushtet me anë të të cilëve, ndërmarrjet energjetike mund të shkyçin dhe rikycin konsumatorët në sektorin e energjisë në Kosovë, dhe përcakton standardet, parimet dhe procedurat e aplikueshme.
- 2.2. Qëllimi i monitorimit ka qenë të shihet për së afërmi mënyra e zbatimit të këtij Rregulli nga personat përgjegjës të divizionit të Rrjetit dhe Furnizimit, vështirësitë me të cilat përballen gjatë zbatimit dhe sa janë të njoftuar me kriteret dhe kushtet e këtij Rregulli.
- 2.3. ZRRE-ja ka vërejtur se personat përgjegjës të KEK-ut nëpër rrethe, nuk aplikojnë në tërësi procedurat që rrjedhin nga ky Rregull:
- a) nuk janë zhvilluar politikat në lidhje me Shkyçjet dhe Rikycjet në sektorin e Energjisë në afat prej tridhjetë (30) ditësh siç parasheh Rregulli;
 - b) mungon njoftimi paralajmërues për shkyçje sipas Nenit 15.2;
 - c) nuk është bërë certifikimi i personave përgjegjës për shkyçje;
 - d) nuk janë bërë publikë emrat e punëtorëve të certifikuar për shkyçje sipas Nenit 4.8 të Rregullit në fjalë;
- 2.4. Nga përgjegjësit për zbatimin e këtij Rregulli na u tha se si kriter për shkyçje, merren për bazë tri faturat e fundit dhe se në rastet kur borxhi kontestohet nga konsumatori nga ai kërkohet të paguajë borxhin e pa kontestuar.
- 2.5. Përgjegjësit na informuan me problemet që kanë ekipet gjatë ekzekutimit të shkyçjeve. Njëri prej problemeve lidhet me konsumatorët që duhet të shkyçen, të cilët duke menduar që t'i shmangen pagesës shtesë për shkyçje dhe rikycje, kërkojnë nga ekipet që të mos i shkyçin me qëllim të kryerjes së menjëhershme të pagesës së borxhit ose riprogramimit. Pastaj të njëjtit ankohen për arsye se u është faturuar taksa për shkyçje. **Rregulli parasheh që akti i shkyçjes të ekzekutohet dhe nuk është në kompetencën e ekipeve të shkyçjes të ndryshojnë vendimin e marrë. Prandaj shpenzimet e shkyçjes nuk mund të eliminohen.**
- 2.6. Gjatë bisedimeve me zyrtarët përgjegjës nëpër Rrethe, kemi vërejtur se **gjatë regjistrimit të konsumatorëve të rinj merret pozicioni i fundit i njehsorit pa marrë parasysh konsumin paraprak, që do të thotë se konsumatorit i falen kWh e energjisë elektrike të shpenzuar paraprakisht.** Zyrtarët përgjegjës deklaruan se kjo procedurë po aplikohet si pasojë e një urdhërese të lëshuar nga Drejtori i Furnizimit në KEK.
- 2.7 **Numri i Vërejtjeve për Shkyçje të lëshuara nga KEK-u**

Tabela 4. Të dhënat për numrin e vërejtjeve për shkyçje që ka nxjerrë KEK (Janar – Qershor 2006)

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
24.122	17.129	15.827	13.785	12.134	11.945	5.472	100.414

Vërejtjet për shkyçje u janë shpërndarë konsumatorëve përmes stafit përgjegjës të KEK-ut për leximin e njehsorëve, me udhëzimin që secili konsumator do të nënshkruajë se ka marrë (pranuar) vërejtjen për shkyçje.

Për shkak të vështirësive në dorëzimin direkt të vërejtjeve, nganjëherë stafi përgjegjës për leximin e njehsorëve i lënë vërejtjet në pronat e konsumatorëve.

2.7.1. Borxhi total për konsumatorët e paralajmëruar se do të shkyçen ka qenë 134,459.823€

2.7.2. Shpenzimet (administrative dhe të dërgesës) të faturuara nga numri i vërejtjeve për shkyçje

Tabela 5. Shpenzimet të faturuara për numrin e Vërejtjeve të dërguara për Shkyçje për periudhën Janar- Qershor 2006 sipas Shtojcës 1 pika A të Rregullit për Shkyçje dhe Rikycje

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
277.403€	196.984€	182.011€	158.528€	139.541€	137.368€	62.928€	1.154.763€

Nga Tabela 5 shihet se KEK-u ka faturuar **1.154.763€** nga numri i vërejtjeve të dërguara për shkyçje

2.7.3. Numri i ekipeve të shkyçjeve

Tabela 6. Numri i ekipeve* për shkyçje sipas Rretheve

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Tot.
19	11	11	8	9	9	3	70

2.7.4. Numri i Konsumatorëve të shkyçur (shkyçjet e realizuara)

Tabela 7. Numri i shkyçjeve të realizuara për periudhën Janar- Qershor 2006

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
9,835	4,424	5,923	4,208	4,237	4,455	1,452	34,534

KEK-u ka shkyçur **34.39%** te numrit të konsumatorëve të paralajmëruar për shkyçje (nga Tabela 4)

2.7.5. Shërbimet dhe Tarifat e Faturuara për Shkyçje dhe Rikycje

Tabela 8. Shërbimet dhe tarifrat e faturuara nga shkyçjet e realizuara për periudhën Janar-Qershor 2006 sipas Shtojcës 1 pika B dhe C të Rregullit për Shkyçje dhe Rikycje

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
679.246€	305.552€	352.820€	145.189€	132.423€	697.820€	50.715€	2.010.945€

* çdo ekip i shkyçjes përbëhet prej dy anëtarëve të stafit

2.7.6 Numri i konsumatorëve të kyçur ilegalisht që janë shkyçur

Tabela 9. Konsumatorët e kyçur ilegalisht e pastaj të shkyçur nga ekipet e shkyçjes për periudhën Janar- Qershor 2006

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
3,150	1,140	1,751	1,685	283	1,194	93	9,296

2.7.7. Gjjobat dhe Tarifat e Faturuara

Tabela 10. Gjjobat dhe tarifat e faturuara për Konsumatorët e kyçur ilegalisht për periudhën Janar - Qershor 2006 sipas shtojcës 1 pika B, C dhe E të Rregullit për Shkyçje dhe Rikyçje

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
425.270€	144.325€	1.534.385€	197.110€	31.360€	161.115€	2.415€	2.495.980€

Shuma e shërbimeve dhe gjjobave nga Tabelat Nr. 5, 8 dhe 10 në total është **5.661.688 €**

2.7.8. Arkëtimi i të ardhurave vjetore nga Shkyçjet

Tabela 11. Arkëtimi nga faturimi i konsumatorëve që kanë marr vërejtje dhe janë shkyçur për periudhën Janar –Qershor 2006

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
4.081.920€	1.918.609€	1.428.629€	1.086.468€	1.049.969€	507.606€	482.160€	10.555.361€

2.7.9. Numri i Konsumatorëve të cilët kanë nënshkruar Kontratë për riprogramimin e borxhit

Tabela 12. Numri i konsumatorëve të cilët e kanë nënshkruar kontratën për riprogramimin e borxhit për periudhën Janar- qershor 2006

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
7,603	5,319	3,537	3,801	4,623	2,367	1,586	28,836

Tabela 13. Shuma e borxhit që është riprogramuar Janar- Qershor 2006

Prishtina	Prizreni	Ferizaj	Gjilani	Peja	Mitrovica	Gjakova	Total
6.584.697€	5.297.380€	8.481.651€	3.109.836€	4.602.608€	2.029.803€	1.129.753€	31.234.728€

2.7.10. Synimi për të sjellë borxhin total prej **134.459.823 €** qoftë si arkëtim apo si ri-programim me kapacitetet e angazhuara të ekipeve të shkyçjes, tregohet që ka qenë jo real. Gjykuar sipas rezultateve të arritura gjatë periudhës Janar-Qershor 2006 (31.555.361 € ri-programim dhe 10.555.361 kesh) KEK-ut i nevojiten edhe 12 muaj që të arrijë efektin e plotë për të sjellë para të freskëta shtesë prej borxhit rreth 20 m€, duke i atakuar konsumatorët me një borxh mesatar prej rreth 1350 € dhe 900 €.

- 2.7.11. Nëse i referohemi shpenzimeve dhe gjobave të ekzekutuara sipas Nenit 2.7.7. në vlerën prej gjithsejtë **5,661,688 €** nuk ka një gjendje të qartë se cilat janë shpenzimet e shkyçjes, cilat janë gjobat dhe sa janë inkasuar në emër të këtyre kategorive, **meqenëse nuk janë mirëmbajtur kontot e ndara për kategoritë e përmendura më lart.**
- 2.7.12. Nuk ka raport ose informacion rreth vjedhjeve dhe shkyçjeve të bëra si pasojë e identifikimit të tyre si dhe efektet e arkëtimit nga ky aktivitet. Humbjet komerciale të nivelit të lartë janë tregues se në këtë drejtim aktiviteti nuk është i përmasave që mund të shprehet me arkëtim të rritur. Nëse vazhdimisht atakohen konsumatorët që janë borxhli por nuk e vjedhin energjinë elektrike mund të ketë efekte kontraproduktive në marrëdhënie të konsumatorëve me KEK-un.
- 2.7.13. Duke ju referuar **Tabelës Nr. 16** që pasqyron lidhshmërinë e rritjes së arkëtimit me procesin e shkyçjeve është një tregues i qartë se relacionet KEK- Konsumator janë akoma në fazat kritike dhe se rritje e arkëtimit më tutje mund të pritët vetëm duke ndërmarrë masa sanksionuese. **Nëse masat sanksionuese janë në rritje, atëherë numri i konsumatorëve pagues të rregullt zvogëlohet gjithnjë mëqë nuk ka lëvizje pozitive të theksueshme në zvogëlimin e humbjeve komerciale.** Diferenca që shpreh rritjen e arkëtimit për periudhën Janar-Qershor (rreth 5.000.000 €) mund të thuhet se është kryesisht rezultat i aksionit të realizuar të shkyçjeve .
- 2.7.14. **Derisa statistikatat tregojnë një rritje të arkëtimit prej mbi 5% për 2006 të dhënat mbi faturimin tregojnë një rënie prej rreth 5% për periudhën Janar-Qershor 2006 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2005.**
Supozimi i rezultateve të sipërpërmendura është:
- **Lexim i pasaktë i njehsorëve në 2005 ose 2006**
 - **Vjedhje e shtuar e energjisë elektrike**

3. Monitorimi i zbatimit të Politikës ABC

- 3.1. Në sesionin e mbajtur më 29 nëntor 2005, Bordi i ZRRE-se ka aprovuar kërkesën e KEK-ut në lidhje me zbatimin e politikës ABC. Vendimi për aprovimin e politikës ABC gjithashtu përmban edhe kushtet që KEK-u duhet të plotësojë lidhur me zbatimin e saj.
- 3.2. ZRRE-së është njoftuar nga KEK-u **se nuk janë në dijeni lidhur me kushtet dhe detyrimet që rrjedhin nga neni 3.1. i Vendimit të sipërpërmendur.**
- 3.3. Orari i reduktimeve për kategorizimin ABC merret prej qendrës dispeçerike dhe zbatohet nga operatorët e vendosur në nënstacione.
- 3.4. Nga Rrethi i Pejës u informuam po ashtu me masat disiplinore të ndërmarra ndaj operatorëve që gjatë operimit nuk kanë përfillur orarin e reduktimeve.
- 3.5. Rastet e iniciativave të KEK-ut që në bashkëpunim me Komunën apo edhe me grupet, shoqatat në qytet dhe fshatra të sensibilizojë qytetarët për të paguar energjinë elektrike kanë qenë shumë të pakta. Për më tepër këto iniciativa kanë buruar nga vetë konsumatorët.
- 3.6. Lista e kategorizimeve ABC përpunohet çdo muaj. Gati në të gjitha daljet 10 kV janë të vendosur njehsorët.
- 3.7. Gjatë periudhës së dimrit ka pasur vështirësi në aplikimin e kësaj politike për shkak të ngarkesave në daljet e trafave, djegieve të kabllove, siguresave dhe problemeve të tjera teknike, si dhe u theksua pamundësia teknike për t'i ndarë konsumatorët e mirë që gjenden në kategorinë C.
- 3.8. Rreth pyetjes se sa janë rezultatet dhe se a është e suksesshme Politika ABC, menaxherët e Rretheve të Pejës, Ferizajt dhe Prishtinës theksuan nevojën e një analize më të hollësishme të rezultateve në terren, e cila është neglizhuar nga personat përgjegjës në KEK. Mirëpo ata u shprehën pozitivisht për parimet të vendosura në këtë politikë.
- 3.9. Sa i përket pyetjes sonë mbi aplikimin e politikës ABC sipas kushteve të parashtruara në Vendimin e ZRRE-së, është konstatuar se ato nuk aplikohen. Politika e regjimit të furnizimit ABC përpos kërkesë së vendosjes së furnizimit më të drejtë për konsumatorët pagues të rregullt, gjithashtu ka pasur për qëllim edhe ndërmarrjen e aksioneve efektive që gradualisht të eliminojnë pasojat e kufizimit në furnizimin me energji elektrike, e kjo nuk është arritur. **Prandaj kushtet e vendosura në vendimin D_08_2005 nuk janë zbatuar. Për më tepër gjatë bisedës me rastin e monitorimit të bërë, bashkëbiseduesit lanë përshtypjen se nuk janë fare të familjarizuar me kushtet e vendosura nga ZRRE-ja.**
- 3.10. Nëse i referohemi pikës 1 të Vendimit **D_08_2005** kemi një vlerësim si më poshtë:

- a) KEK-u do t'i sigurojë ZRRE-së informacione të qarta mbi numrin e konsumatorëve të rregullt (kategoria A) dhe atyre të ulët ose që nuk paguajnë (kategoritë B & C) në çdo furnizues.

Statusi: Nuk është zbatuar

- b) KEK-u do t'i dorëzojë çdo Komune të prekur nga programi C, listën e konsumatorëve mos-pagues ose konsumatorëve që paguajnë pak. Komuna në bashkëpunim me KEK-un do të informojë siç duhet, këta konsumatorë mbi politikën dhe pasojat e mos-pagimit ose përdorimit të paligjshëm të energjisë.

Statusi: Nuk është zbatuar. Rasti i iniciativave të veçanta të raportuara ka vërtetuar efektshmërinë e kësaj kërkesë (Pejë);

- c) KEK-u do të marrë të gjithë masat e mundshme për të siguruar **daljet** e dedikuara nga konsumatorët e mirë-që paguajnë, të cilët e gjejnë veten në kategorinë C, në grupin tarifor 6 e përpjetë, në rast se këta konsumatorë i kërkojnë këto. KEK-u do t'i dorëzojë ZRRE-së një propozim mbi tarifën e rrlidhjes me mundësinë për të ndarë pjesëmarrjen në këto tarifa, mes KEK-ut dhe Konsumatorit.

Statusi: Nuk ka pasur kërkesë nga KEK-u lidhur me vendosjen e ndonjë tarife për këso rastesh.

- d) Sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se fundi i janarit 2006, KEK-u do t'i dorëzojë ZRRE-së për aprovim, propozimin e vet për kompensimin e Konsumatorëve të mirë që paguajnë, të cilët janë brenda zonave të klasifikuara si B ose C;

Statusi: Nuk është zbatuar

- e) Gjatë zbatimit të politikës ABC, KEK-u do t'i trajtojë me mënyrë të barabartë, jo diskriminuese dhe të qëndrueshme të gjithë konsumatorët në Kosovë;

Statusi: Nuk është zbatuar me përpikëri (rast i raportuar në Pejë ku dalja e kategorisë C furnizohet pa ndërprerje)

- f) Gjatë zbatimit të kësaj politike, KEK-u do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë masat disiplinore të stafit përgjegjës për veprimet kontrolluese, në mënyrë që të zbatojnë politikën ABC, pra që të shmangin rrezikun e dështimit dhe të arrijnë rezultatet e duhura;

Statusi: Janë raportuar masat disiplinore të ndërmarra vetëm gojarisht gjatë monitorimit.

- g) KEK-u do të vazhdojë të aplikojë shkyçjen individuale për Konsumatorët mos-pagues dhe/ose ata që janë të lidhur ilegalisht (**Vendimi Nr. D_02_2005 i ZRRE-së**) dhe do të monitorojë punën e ekipeve të shkëputjes, si dhe do të zbatojë rregulla të rrepta disiplinore në rastin e moszbatimit ose zbatimit kundrejt politikës ABC, Vendimin mbi Shkyçjen dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm;

Statusi: Është zbatuar. Vlerësimi i implementimit mund të shihet në Kapitullin 2 të këtij Raporti.

- h) Menjëherë pas aprovimit të kësaj politike, KEK-u do të krijojë shërbimin për informimin e konsumatorëve që do të merret me ankesat e konsumatorëve dhe do të informojë konsumatorët mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.;

Statusi: Është zbatuar.

- i) KEK-u do të informojë ZRRE-në në baza dy mujore, mbi arritjet e politikës ABC, përfshirë informacionin mbi numrin e ankesave të Konsumatorëve, bazuar në kategoritë e tyre dhe në numrin e ankesave të zgjidhura/të pazgjidhura;

Statusi: Nuk është zbatuar

- j) KEK-u do të vazhdojë fushatën mbi marrëdhëniet publike në nivele të ndryshëm, përfshirë vetëdijesimin publik në nivel lokal dhe në komunitet; përpara çdo njoftimi, ose përndryshe ekspozohet ndaj reputacionit të rrezikuar në rast se një politikë e shpallur publikisht nuk është zbatuar.


Statusi: Në nivelin qendror është zbatuar ndërsa në nivel e komunitetit dhe atë lokal nuk është zbatuar .

3.11. Statistikat e politikës ABC

Tabela 14. Përmbledhje e të dhënave në lidhje me kategorizimin sipas politikës ABC për të gjitha Rrethet

Përmbledhje e të dhënave për shtatë Distriktet							
Muaji	Totali # për Konsumatorë	# për Konsumatorët në Kategorinë A	% për Konsumatorët në Kategorinë A	# për Konsumatorët në Kategorinë B	% për Konsumatorët në Kategorinë B	# për Konsumatorët në Kategorinë C	% për Konsumatorët në Kategorinë C
Tetor-05	324.317	100.623	31%	116.489	36%	107.205	33%
Nënto-05	324.420	99.716	31%	118.221	36%	106.483	33%
Dhje-05	326.239	99.891	31%	118.347	36%	108.001	33%
Jan-06	327.018	80.619	25%	167.323	51%	79.076	24%
Shku-06	327.018	80.619	25%	167.323	51%	79.076	24%
Mars-06	329.247	69.699	21%	167.824	51%	91.724	28%
Prill-06	329.900	75.167	23%	157.649	48%	97.084	29%
Maj-06	339.325	79.653	23%	141.244	42%	118.428	35%
Summary	2.288.159	606.334	26%	1.013.176	44%	668.649	29%

Tabela 15. Grafik i të dhënave në lidhje me ketgorizimin sipas politikës ABC për të gjitha Distriktet



Statistikat e ndryshimeve të numrit të konsumatorëve gjatë muajve të zbatimit të regjimit të furnizimit “ABC” tregojnë se lëvizjet kryesisht janë bërë si pasojë e kërkimit të përqindjes më të lartë të normës së arkëtimit (inkasimit) dhe shumë më pak si përgjigje të konsumatorëve, duke marrë parasysh se nëse ata rrisin shkallën e pagesës, do të kenë një cilësi më të mirë furnizimi. Duket se gjatë muajve Janar-Shkurt konsumatorët e grupit “C” kanë pasur tendencë të përmirësojnë pozitën e tyre por në vazhdim kjo situatë përkeqësohet.

Ndonëse regjimi i furnizimit ABC kryesisht në masën më të madhe ka pasur si qëllim ofrimin e cilësisë më të mirë të furnizimit ndaj konsumatorëve që paguajnë, përveç situatave të krizës, mundësia që ky regjim i furnizimit të rrisë shkallën e arkëtimit nuk është shfrytëzuar me efektivitet. Së fundmi, si pasojë e rezultateve të dobëta, rrjedh se nuk janë aplikuar dispozitat e vendimit të ZRRE-së, në veçanti kufiri i ngushtë me konsumatorët.

4. STATISTIKAT NË LIDHJE ME FATURIMIN, ARKËTIMIN PËR VITET 2005 DHE 2006

Tabela 16. Të dhënat në lidhje me Faturimin dhe Inkasimin për periudhën 2005 – 2006

Muajt	2005	2005	2005	2006	2006	2006	Diferenca në Inkasim 2005-2006	Diferenca 2005-2006	Raporti I faturimit 2005-2006
	Faturimi në €	Inkasimi	%	Faturimi në €	Inkasimi	%	€	%	%
	Janar	13.394.073,00	5.627.086,00	42,01%	12.792.015,41	7.694.520,12	60,15%	2.067.434,12	18,14%
Shkurt	13.484.630,00	6.551.613,00	48,59%	11.669.942,05	8.152.610,22	69,86%	1.600.997,22	21,27%	-13,5%
Mars	12.750.478,15	7.957.162,00	62,41%	13.588.048,03	8.046.212,25	59,22%	89.050,25	-3,19%	6,6%
Prill	9.515.853,00	8.421.209,00	88,50%	9.492.246,17	8.412.676,53	88,63%	- 8.532,47	0,13%	-0,2%
Maj	8.993.825,00	7.522.378,00	83,64%	9.612.341,31	8.284.294,99	86,18%	761.916,99	2,54%	6,9%
Qershor	8.504.630,00	5.829.000,00	68,54%	8.954.221,40	7.043.621,25	78,66%	1.214.621,25	10,12%	5,3%
Korrik	8.134.249,12	6.016.809,00	73,97%	-	-	#DIV/0!		#DIV/0!	
Gusht	7.901.564,00	5.883.884,00	74,46%	-	-	#DIV/0!		#DIV/0!	
Shtator	8.277.932,00	6.743.988,00	81,47%	-	-	#DIV/0!		#DIV/0!	
Tetor	10.560.525,09	5.762.878,00	54,57%	-	-	#DIV/0!		#DIV/0!	
Nëntor	11.419.098,33	7.060.000,00	61,83%	-	-	#DIV/0!		#DIV/0!	
Dhjetor	11.957.715,00	9.763.739,00	81,65%	-	-	#DIV/0!		#DIV/0!	
Gjithë.	124.894.572,69	83.139.746,00	66,57%	66.108.814,37	47.633.935,36	72,05%	5.725.487,36	5,49%	-5,1%

Diagrami ne lidhje me Faturimin dhe Inkasimin për periudhën 2005 – 2006 nga Tabela 16




Tabela 17. Të Dhënat dhe Diagrami në lidhje me Energjinë e Faturuar në kWh në periudhën 2005 – 2006

Muajt	2005	2006	2005-2006	2005-2006
	Faturimi në kWh	Faturimi në kWh	Diferenca kWh	Raporti
	Janar	188.103.566,00	184.277.562,86	- 3.826.003,14
Shkurt	189.437.907,00	166.142.274,80	- 23.295.632,20	0,88
Mars	178.341.470,00	193.745.399,35	15.403.929,35	1,09
Prill	165.356.258,00	167.847.329,75	2.491.071,75	1,02
Maj	156.668.343,00	172.960.450,83	16.292.107,83	1,10
Qershor	146.979.990,00	165.461.775,00	18.481.785,00	1,13
Korrik	143.035.405,00	-	-	
Gusht	135.483.016,00	-	-	
Shtator	142.358.561,00	-	-	
Tetor	149.707.655,00	-	-	
Nëntor	163.496.532,98	-	-	
Dhjetor	170.967.805,00	-	-	
Gjithë.	1.929.936.508,98	884.973.017,59	-	





Tabela 18. Të Dhënat dhe Diagrami në lidhje me Borxhet dhe dallimi ndërmjet në periudhën 2005 – 2006 në nivel qendror

Muajt				
	2005	2006	2005-2006	2005-2006
	Borxhi €	Borxhi €	Diferenca €	Raporti
Janar	7.513.536,32	5.062.164,54	- 2.451.371,78	0,67
Shkurt	6.819.306,15	3.411.733,04	- 3.407.573,11	0,50
Mars	4.627.817,19	5.442.981,72	815.164,53	1,18
Prill	858.123,78	948.012,88	89.889,10	1,10
Maj	1.262.981,54	1.273.736,37	10.754,83	1,01
Qershor	2.516.112,41	1.873.981,51	- 642.130,91	0,74
Korrik	2.078.828,57	-	-	0,00
Gusht	2.060.638,31	-	-	0,00
Shtator	1.496.417,58	-	-	0,00
Tetor	4.785.076,45	-	-	0,00
Nëntor	4.333.897,15	-	-	0,00
Dhjetor	2.056.815,56	-	-	0,00
Gjithë.	40.409.551,02	18.012.610,07	- 22.396.940,95	0,45



VI. UDHËZIMET:

1. KEK-u udhëzohet që brenda tridhjetë (30) ditësh prej datës së publikimit të këtij Raporti, duhet të **hartojë politikat për zbatimin e Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme për Furnizim me Energji dhe Rregullit për Shkycje dhe Rikycje të konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, sipas pikës a) dhe b) dhe t'i dërgojë ato për miratim në ZRRE. Propozimi duhet të përqendrohet në prioritetet vijuese:**

 - a) Masat organizative që qartë përcaktojnë përgjegjësit e funksioneve të furnizimit dhe rrjetit shpërndarës;
 - b) Hartimi i dokumenteve dhe procedurave të kërkuara që janë të lidhura me zvogëlimin e humbjeve komerciale (kyçjet e konsumatorëve, vjedhjet dhe korrupsionet e njehsorëve, mekanizmi i kontrollit dhe procedurat e grumbullimit të fakteve për rastet që i nënshtrohen ligjeve për kriminalitet) si dhe planit veprues për zbatimin e tyre.
 - c) Hartimi i dokumenteve prioritare që kërkohen për implementim në fazat e mëvonshme të përcaktimit të marrëdhënieve Rrjeti i Shpërndarjes me Furnizues dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit etj., kontratat me konsumator **(të dërgohet sipas afateve të dhëna në Rregullin e Kushteve të Përgjithshme për Furnizim me Energji)**

2. KEK-u udhëzohet që brenda një periudhe të shkurtër prej tridhjetë (30) ditësh prej datës së publikimit të këtij Raporti, duhet të **hartojë politikat, procedurat dhe planin veprues të zbatimit të Rregullit për Zgjidhjes e Kontesteve dhe t'i dorëzojë në ZRRE për miratim.** Politikat dhe procedurat me prioritet duhet të përfshijnë:
 - Metodologji të qëndrueshme të leximit që siguron një saktësi më të pranueshme të faturimit që do të shmangë numrin e ankesave të konsumatorëve;
 - Vendosja e një mekanizmi të komunikimit në mes të Rrjetit të Shpërndarjes dhe Furnizimit për ankesat e konsumatorëve që lidhen me problematikën e kualitetit të shërbimit.
3. Sa i përket zbatimit të regjimit të furnizimit “ABC”, KEK-u udhëzohet që brenda **njëzetë (20) ditësh prej datës së publikimit të këtij Raporti duhet të njoftojë ZRRE-në për masat e ndërmarra për zbatimin e dispozitave të Vendimit të ZRRE-së që nuk janë aplikuar deri më tani, dhe për këtë, do të bëjë raportimin përkatës.**

Në rast të tentimit të zbatimit të kriterëve të humbjeve komerciale në kategorizimin e konsumatorëve sipas regjimit të furnizimit “ABC”, KEK-u duhet të aplikojë sërish për pëlqim përpara zbatimit të ndryshimeve eventuale të vendimit paraprak.
4. KEK-u **menjëherë** duhet të ndërmerr **masat dhe veprimin e duhur që shpenzimet dhe gjobat e marra nga konsumatori t'i regjistroj ndaras dhe që kategoritë e gjobave të derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës** sipas

ligjit në fuqi. Të hyrat e realizuara nga shpenzimet e shkyçjes dhe rikyçjes gjithashtu duhet të regjistrohen dhe raportohen ndaras nga të hyrat nga shitja e energjisë elektrike.

5. KEK-u në bazë të Rregullit mbi Masat Administrative dhe Gjobat brenda një periudhe shumë të shkurtër (jo më gjatë se tridhjetë 30 ditë nga dita e publikimit të këtij Raporti), do të paraqesë në ZRRE-së **listën e zyrtarëve të vet që janë përgjegjës për zbatimin e dispozitave të veçanta të legjislacionit rregullativ si p.sh.**
 - Përgjegjës për faturim dhe arkëtim të pagesave prej konsumatorëve;
 - Përgjegjës për të hartuar ofertat, kontratat, faturat, deklaratat dhe njoftimet që u adresohen konsumatorëve;
 - Përgjegjës që merret me ankesat e konsumatorëve të vet sipas dispozitave të Rregullit mbi Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
 - Përgjegjës për kyçe të re të dorëzuar nga shfrytëzuesit e sistemit ose konsumatori i privilegjuar;
 - Përgjegjës për lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve;
 - Përgjegjës për Shkyçje dhe Rikyçje të konsumatorëve në sektorin energjetikë;
 - Përgjegjës për Konsumim të paautorizuar të energjisë, Vjedhje të energjisë dhe Korrupsion të njehsorit etj.
6. Në rast se nuk veprohet sipas Udhëzimeve të sipërpërmendura, ZRRE-ja do të veproj sipas dispozitave përkatëse të legjislacionit sekondar dhe Ligjit të Rregullatorit të Energjisë.
7. Ky Raport do ju dërgohet KEK-ut, publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, gazetat ditore dhe do të konsiderohet si dokument publik që nuk kundërshton parimet e Rregullit të Konfidencialitetit të Informatave.
8. **ZRRE planifikon monitorimin e ardhshëm në Nëntor të vitit 2006.**